



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 648 prot. i AK, datë 02.10.2024 “Përqendrimi me përfitim të kontrollit të Idemia Identity & Security France nga Imprimerie Nationale – Njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar të përfimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.

Referuar dokumenteve të depozituara, palët në transaksion janë:

**Pala blerëse: IMPRIMERIE NATIONALE (IN)** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez, shoqëri holding e IN Group. IN është në pronësi të plotë të shtetit francez dhe është përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve të sigurta të identitetit në Francë (pasaporta, leje drejtimi, karta identiteti etj.).

**Pala shitëse: Idemia France** është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, e cila ofron produkte dhe shërbime të lidhura me sigurinë si: hyrje në makinë pa çelës, kartë SIM, teknologji për njohjen e fytyrës, digjital banking, menaxhim abonimi, etj. Idemia France u shërben institucioneve financiare, operatorëve celularë dhe industrive të sigurisë publike në mbarë botën.

**Target: Idemia Identity & Security France S.A.S** është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, me objekt aktiviteti: shfrytëzimi i të gjitha ndërmarrjeve që kanë të bëjnë me zbatimet e përgjithshme të teknologjive të informacionit, të elektronikës, të optikës dhe të kriptologjisë në fushat e sigurisë, veçanërisht për transaksionet elektronike dhe identifikimin e personave dhe të pasurive.

Targeti, nëpërmjet shoqërisë ALAET SHPK në Shqipëri ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**